



30/12/2024

Krujë – Goditen 2 Raste Të Shitjes Së Lëndëve Piroteknike

Krujë

Si rezultat i kontrolleve të shtuara në zbatim të planit të masave për garantimin e rendit dhe sigurisë gjatë periudhës së festave, goditen 2 raste të shitjes së lëndëve piroteknike.

Procedohen penalisht 2 shtetasit që shitnin fishekszjarrë dhe kapsolla në dyqanet e tyre.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Krujë, nga kontrollet e përditshme në terren, kanë konstatuar 2 dyqane ku shiteshin lëndë piroteknike. Në vijim të veprimeve për këto raste, u referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasit:

A. Sh., 56 vjeç dhe E. Gj., 25 vjeç, të dy banues në Krujë.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan dhjetëra fishekszjarrë dhe kapsolla që u gjetën në këto 2 dyqane.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Në zbatim të planit të masave, shërbimet e Policisë do të jenë në gatishmëri të përforcuar, për të garantuar rendin dhe sigurinë gjatë ditëve festive. Policia apelon për qytetarët që të denoncojnë rastet e tregtimit apo përdorimit të kundërligjshëm të lëndëve piroteknike, duke iu garantuar reagim të menjëhershëm për ndëshkimin e shtetasve përgjegjës.



Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ [Tiranë – Qarkullonte me armë zjarri, falë inteligjencës policore, kapet dhe vihet në pranga 15-vjeçari](#)

[Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë, gjatë 24 orëve të fundit ▶](#)